



Pranuar / Dorezuar Priljetohet/Produkt Received/Delivered	17-10-2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHUCK	6273/2022		113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 756/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave nga: nga: Eshref Shabani kryetar Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.756/2022 të datës 01.09.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë fshati kundër organit të punësimit/Komuna e Ferizajt, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 17.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa A.nr. 756/2022 e datës 01.09.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi fillimisht sipas Akt Emërimit të datës 04.11.2011 ka qenë i punësuar në pozitën Zyrtar Administrativ në Komunën e Ferizajt, ndërsa sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 01.12.2020 është emëruar në pozitën Udhëheqës i Sektorit të Arkivës me koeficient tetë (8).

Ankuesi duke e parë që nuk po bëhet zbatimi i Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 01.12.2020, më datë 01.09.2022 me numër protokolli 5062/2022, ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në

Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.09.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Ferizajt. Ndërsa Këshilli me datë 19.09.2022, ka pranua nga Komuna e Ferizajt, përgjigjen në kërkesë me numër protokoli: 5479/2022, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 756/2022 të datës 01.09.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë e datës 13.02.2020; Ndryshimi dhe plotësimi i Akt emërimi i datës 01.12.2020; Lista e pagave e muajit korrik të vitit 2022, Akt Emërimi i datës 01.11.2011; Përgjigje në ankesë e datës 19.09.2022, me numër protokoli 5479/2022, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesi është *e pa lejuar, sepse:*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që t'i bëhet kompensimi i koeficientit tetë (8) sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt Emërimit të datës 01.12.2020.

Lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesit, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se që nga datë 01.12.2020 kur është nënshkruar Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt Emërimit, nga ankuesi dhe meqenëse nuk është bërë zbatimin i ti sipas koeficientit tetë (8), ankuesi nuk ka ndërmarr asnjë veprim me qëllim të pretendimeve për zbatimin e tij, rrjedhimisht ankuesi nuk ka parashtruar asnjëherë kërkesë tek organi i punësimit, po ashtu në bazë të provave të lëndës pas nënshkrimit të ndryshimit dhe plotësimit të aktit të emërimit nuk ka asnjë dëshmi që organi i punësimit të ketë marr veprime për zbatimin e tij.

Bazuar në këto, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesi për njohjen e të drejtës së tij, para parashtrimit të ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk i është drejtuar paraprakisht me kërkesë udhëheqësit më të lartë administrative si organ kompetent për trajtimin e kësaj çështje në kuadër të organit të punësimit, rrjedhimisht me këtë objekt të ankesës nuk kemi veprim aspo mosveprim nga udhëheqësi më i lartë administrativ në raport me të drejtën e pretenduar me ankesë, për çka ankuesi mund të kontestonte ligjshmërinë e veprimit të organit të punësimit, apo mosveprimit të tij, siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht me nenin 34 paragrafi 3, i cili përcakton se: *"Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji..."* si dhe nenin 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim..."*.



Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se çështja parashtrimit të ankesës kundër vendimeve të organit të punësimit është përcaktuar edhe me nenin 16 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: *“Nëpunësi civil, apo kandidati për praninë në shërbimin civil i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshill, lidhur me pretendimin për shkeljen e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës”*, andaj meqenëse ankuesi në këtë procedurë administrative nuk ka parashtruar fillimisht kërkesë tek udhëheqësi më i lartë administrativ i cili konsiderohet punëdhënës i ankuesit, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson që nuk janë përmbushur kushtet ligjore për pranueshmërinë e ankesës së ankuesit, siç parashihet me nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si rrjedhojë ankesa A.nr.756/2022 e datës 01.09.2022, e parashtruar nga ankuesi për arsye të lartcekura dhe në këtë fazë është e papranueshme.


Siç u tha me sipër, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr. 756/2022

Rushit KAJTAZI



Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

Ankuesit

Kryetarit të Komunës së Ferizajt;

Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Ferizajt;

Arkivit të KPMSHCK-së

